




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK.nr.388/2023**  
**Datë: 31 gusht 2023**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 5, të Rregullores nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, në mbledhjen 314-të, të mbajtur me datë 31 gusht 2023, merr këtë:

### **V E N D I M**

- I. Themelohet Komisioni për Rekrutimin e administratorit në Gjykatën Supreme të Kosovës, në përbërjen si në vijim:
  1. Teuta Ibrahim, anëtare e KGJK-së/kryetare e komisionit;
  2. Arjeta Sadiku, anëtare e KGJK-së/anëtare e komisionit;
  3. Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së/anëtar i komisionit;
  4. Fejzullah Rexhepi, Kryetar i Gjykatës Supreme/anëtar i komisionit;
  5. Shkëlzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së/anëtar i komisionit;
  6. Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë;
  7. Astrit Hoti, Drejtor i Departamentit Ligjor në Sekretariatit e KGJK-së/anëtar rezervë.
- II. Komisioni ka mbështetje administrative dhe profesionale nga Njësia për Inspektim Gjyqësor.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 31 gusht 2023.

### **A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.387/2023, të datës 31 gusht 2023, ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën administrator të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi në këtë takim ka themeluar edhe komisionin për rekrutim, konform nenit 5 të Rregullores nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, në përbërjen si në dispozitiv të këtij vendimi.

Qerim Ademaj

Zëvendës Kryesues i Keshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Anëtarëve të Komisionit;
- Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit.